



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Nr. 553/2023
Datë: 08.08.2023

Kryeministri i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 94 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 9 (1.3 dhe 1.4) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 6 (2.1 dhe 2.9), të Rregullores (QRK) - Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) nr. 04/2021 dhe Rregulloren (QRK) nr. 03/2022, nxjerr:

V E N D I M

1. Z. Ejup Maqedonci emërohet Ministër i Ministrisë së Mbrojtjes.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrit të Ministrisë së Mbrojtjes janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, me legjislacionin në fuqi, si dhe kryen detyra tjera shtesë të caktuara nga Kryeministri.
3. Z. Maqedonci është i obliguar të bëjë deklarinimin e pasurisë, në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-108 për deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave.
4. Obligohet Ministria e Mbrojtjes dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Vendimi i dërgohet:

- Z. Ejup Maqedonci, Ministër i Mbrojtjes;
- Të gjithë Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë Ministrave;
- Shefit të Stafit të Kryeministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.